

Nr. 11.09.2025

3250/



Nr 3250/7 Prot

Sh. 11/9/2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. 750/1 prot.

Kukës më, 11.09.2025

L E N D A : Verifikimi i Ligjshmërisë së Aktit.

KRYETARIT TË BASHKISË

KËSHILLIT BASHKIAK

TROPOJË

Në protokollin e Prefektit të Qarkut Kukës është regjistruar vendimi i këshillit bashkiak Tropojë me nr.3250/6 prot. datë 10.09.2025, protokolluar me tonën me nr.750 prot. datë 11.09.2025. Bazuar në ligjin "Për Prefektin e Qarkut" (i ndryshuar) neni 16, shqyrtuam vendimin e Këshillit Bashkiak Tropojë të miratuar në mbledhjen e datës 04.09.2025 si dhe dokumentacionin plotësues për vendimin si më poshtë:

Vendim nr.48 datë 04.09.2025 i Këshillit bashkiak Tropojë "Për miratimin e planit vendor të menaxhimit të integruar të mbetjeve të bashkisë Tropojë", është në përputhje me ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), neni 23 pika 10, ligjin nr. nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (i ndryshuar) neni 12 pika 2, neni 13 pika 5 paragrafi I.

Shënim: Sa i përket procedurës për hartimin dhe miratimin e planeve rajonale dhe vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve është detyrë e bashkisë dhe këshillit bashkiak ndjekja dhe zbatimi i hapave ligjorë sipas përcaktimeve të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (i ndryshuar) neni 13 pika 2 dhe pika 5 paragrafi 2.

Gjithashtu pika 7 e nenit 13 e ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve" (i ndryshuar) përcakton se: **"Plani vendor i menaxhimit të integruar të mbetjeve hyn në fuqi vetëm pas miratimit nga këshilli i qarkut"** Pra sa më sipër ky vendim nuk hyn në fuqi sipas ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 55 pika 6.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

P R E F E K T I
Dritan Baji

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Donald Korbi



I.T.
Dr. Shënimor
Sekretar i Këshillit
Sh. 11.09.2025
J. J.